



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr. 8 datë 06/03/1995

**PER
RRITJEN E PAGAVE PER KESHILLAT DREJTUES TE
NDERMARRJEVE LOKALE TE INDUSTRISE.**

Këshilli Bashkiak i Tiranës, në mbledhjen e dt.06.03.1995, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Seksioni i Prognozës “Për rritjen e Pagave të Këshillave Drejtuese të Ndërmarrjeve Lokale të Industrisë”, në zbatim të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.463, dt.03.10.1994 “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.463, dt.03.10.1994 “Për disa ndryshime në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.345, dt.10.08.1992, për shpërblimin e punës së punonjësve. Mbështetur në kompetencat që ka Këshilli Bashkiak, mbështetur në ligjin “Për ndërmarrjet shtetërore” Nr.7582, dt.13.07.1992, neni.19, pika.5 dhe në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit lokal” Nr.7572, dt.10.06.1992, neni.14, pika.10

V E N D O S I

1. Aprovimin e pagës për Uzinën Elektromjeksore

Paga e Drejtorit dhe Kryetarit të Këshillit Drejtues, vendoset të jetë 8.000 lekë në muaj.

2. Për anëtarët e Këshillit drejtues paga e tyre vendoset 12 – 20 përqind më e vogël se paga e drejtorit.
3. Sipas vendimit të K.Ministrave Nr.423, dt.03.10.1994, drejtori i ndërmarrjes dhe anëtarët e tjerë të Këshillit drejtues përfitojnë rritje mbi pagë mbi 5 deri në 70 përqind në të njëjtën masë që do të

përfitojnë dhe punonjësit e tjerë të ndërmarrjes, kur i plotëson kushtet e përcaktuara në dispozitat ligjore.

4. Këto paga do të zbatohen nga 1 Tetor i vitit 1994.

KRYETARI

BESNIK PETRELA